

**PERCEPTIMI I BULLIZMIT NË SHKOLLAT FILLORE TË KOSOVËS
EKSPOZE E TEMËS SË MASTERIT**

NGA

MIHANE FETAHU



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
” HASAN PRISHTINA ”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË
TETOR, 2022**

Mentor:

Prof.Ass.Dr: Gëzim Selaci

Kandidatja:

Mihane Fetahu

Problemi i bullizmit në shkolla është një çështje me rëndësi kombëtare. Bullizmi në shkolla është një problem madhor që mund të ndikojë në arritjet akademike dhe mirëqënien e përgjithshme të nxënësve. Ai gjithashtu vazhdon të paraqesë marrëdhëniet me shoqërinë dhe sfidat ligjore për shkollat lokale dhe rrethet shkollore. Duke pasur parasysh përkufizimet e shumta të bullizmit, statistikën e ndryshme mbi normat e prevalencës dhe perceptimet e ndryshme të viktimizimit, mund të pyesim veten se sa të ndryshëm mund të jenë këto perceptime në të gjithë sistemin shkollor?

Qëllimi i studimit tim është të eksploroj mbi perceptimet e mësimdhënësve dhe nxënësve, dhe veprimet që ata ndërmarrin për të trajtuar dhe parandaluar bullizmin.

Andaj, në këtë hulumtim janë studiuar perceptimet për bullizmin në shkollë, sjelljet, format prezente dhe mënyrën se si i trajtojnë/reagojnë në situata bullizuese. Të dhënat e këtij hulumtimi shërbejnë si informim, dhe plotësim të njohurive, për perceptimin mbi bullizmin.

Ky studim me natyrë eksploruese, hulumtoi jo vetëm perceptimet e nxënësve dhe mësimdhënësve ndaj bullizmit, por edhe natyrën e tij, dhe se si vetë bullizmi lidhet me çështje të tjera psiko sociale, ekonomike etj. Në këtë studim morën pjesë gjithsej 21 pjesëmarrës, nxënës të shkollave fillore, mësimdhënës dhe një psikologe. Ky studim u mbështet në të dhënat (cilësore) primare dhe sekondare.

Ky punim fillon me një abstrakt të shkurtër, dhe të përmbledhur me pikat kryesore të këtij punimi. Pastaj vazhdon me kapitullin e parë, në të cilën përfshin hyrjen, deklaratën e problemit dhe të rëndësisë, qëllimin e studimit, pyetjet kërkimore, bazën teorike, në të cilën përshkruhen teoritë kryesore të autorëve lidhur me këtë temë. Pastaj kapitulli i dytë vazhdon me një shqyrtim literature të autorëve, hulumtuesëve dhe koncepteve më të zgjeruar të hulumtimit, përfshirë qasjen në aspektin lokal dhe më gjerë. Kurse kapitulli i tretë përfshin metodologjinë hulumtuese, duke filluar me disajnin e kërkimit, pjesëmarrësit, mostra, instrumentet, procedura, mbledhja dhe analiza e të dhënave, analiza e të dhënave primare dhe sekondare, si dhe besueshmërinë e këtij studimi. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur Analiza tematike e të dhënave cilësore, me metodën induktive, nga softveri QCAmap. Të dhëna nga zhvillimi i intervistave, fokus grupeve, vëzhgim me pjesëmarrje, gjeneruan kryesisht pjesën cilësore të këtij studimi. Dhe në kapitullin e katërt, përshkruhen të dhënat e intervistave, dhe fokus grupeve si dhe i jipet një interpretim, nga instrumenti përkatës, si dhe jipen rezultatet dhe diskutime të mbështetura me

të dhëna sekndare. Nga përpunimi i të dhënave, janë përzgjedhur tema që lidhen me perceptimet e nxënësve për natyrën dhe elementet e bullizmit në shkollë.

Kurse, në kapitullin e fundit, kapitulli i pestë, jipet konkluzioni, diskutim dhe rekomandime.

Si qëllim kryesor i këtij hulumtimi është të kuptuarit e perceptimit të bullizmit nga mësimitdhënësit dhe nxënësit e dy shkollave fillore. Gjithashtu qëllimi im është të kuptoj edhe elementet e tjera të bullizmit, si qëndrimet ndaj bullizmit, format e bullizmit që ndodhin, të tilla si: fizik, verbal dhe social, dhe më shumë – me qëllim trajtimin e tyre.

Përshkrimi i bullizmit dhe perceptimin ndaj tij – Hulumtimi do të shtjellojë kornizën teorike fillimisht mbi këtë çështje nga autorë dhe studiues të shumtë mbi definicionin e bullizmit. Dhe, pastaj do të ketë qëllim marrjen e informatave nga nxënësit dhe mësuesit e shkollave se çfarë perceptimesh kanë për bullizmin duke u bazuar në njohuritë e tyre.

Trajtimi i bullizmit dhe marrëdhënia mësues – nxënës në parandalimin e tij- Në këtë aspekt qëllimi im është të dihet raporti ndërmjet nxënësve dhe mësuesit/eses në trajtimin e bullizmit, dhe të dihet se a janë të vetëdijshëm për praktikatat (sjelljet) e bullizmit dhe parandalimin e tyre.

Pyetjet kërkimore:

Pyetjet më poshtë janë të përmbledhuara duke ua adresuar mësimitdhënësit dhe nxënësve të dy shkollave fillore në Kosovë.

- Pyetja kërkimore 1: Çfarë perceptimesh kanë (si e perceptojnë) mësimitdhënësit dhe nxënësit për bullizmin?
- Pyetja 2: A janë të vetëdijshëm për praktikatat(sjelljet) e bullizmit dhe parandalimin e tyre?

Duke u bazuar në dy pyetjet kërkimore më sipër, hulumtimi do të trajtojë këto nënçështje tek mësimitdhënësit, dhe nxënësit.

Tek mësimitdhënësit do të trajtohen:

- *Njohuritë dhe perceptimi mbi bullizmin*
- *Vetëdijësimi për ekzistimin e bullizmit në ambient shkollor*
- *Format e bullizmit dhe pasojat e tyre*
- *Strategjitë për menagjimin/reduktimin e bullizmit*
- *Njohuritë për programe/politikat e ngacmimit*

Kurse me nxënësit do të trajtohen poashtu nënçështjet e përafërta me mësimdhënësit të tilla si:

- *Raporti i nxënësve*
- *Bullizmi dhe format e tij*
- *Mbështetja tek mësimdhënësit për menagjimin e bullizmit*
- *Reagimet ndaj fenomenit të bullizmit*
- *Këndvështrimi i nxënësve si të meangjohet bullizmi*
-

Rezultatet

Të dhënat cilësore, zbuluan se mësimdhënësit dhe vetë nxënësit janë të vetëdijshëm për prezencën e bullizmit dhe formave të tij në mjedisin e tyre shkollor. Lloji verbal është lloji më i zakonshëm i përjetuar dhe prezent në këto dy shkolla, i përshkallëzuar në dhunë.

Por, në raste të veçanta, bullizmi nuk raportohet në këto shkolla. Të dhënat e këtij studimi tregojnë, se shpesh mungesa e burimeve, trajnimeve dhe qasjes efektive në menagjimin e bullizmit ndikon në këtë raport.

Andaj, duke u bazuar në studime të shumta, dhe nga të dhënat e këtij hulumtimi, perceptimi ndaj bullizmit në këto shkolla përfshin termin e disbalancit të fuqisë, përsëritjes dhe dhunës. Gjithashtu, mjedisi shkollor, kultura, dhe vetë ndërtimi i sistemit mikro-makro, ndikojnë në vështirësimin/lehtësimin e situatave bullizuese.

Për më tepër, ky hulumtim dhe shumë studime theksojnë lidhjen midis bullizmit dhe kategorive sociale, gjë që nxjerr në pah aspektet makro të bullizmit.

Perceptimet e mësuesve ndaj bullizmit të të gjitha formave ndikojnë në përfshirjen e tyre për të ndërhyrë. Andaj të gjeturat e këtij studimi tregojnë se ndërgjegjësimi ndaj bullizmit është i lidhur me ndërhyrjen në këto situata.

Andaj, edhe duke u bazuar në studimet ku është hulumtuar perceptimi i nxënësve mbi atë ç'ka bëjnë mësuesit për të ndërprerë bullizmin që ndodh mes nxënësve, u zbulua se nxënësit raportojnë se mësuesit e tyre bëjnë shumë pak për të ndërprerë këtë fenomen. Megjithëse, një pjesë e tyre kërkon ndihmë kur përballen vetë me situata bullizuese, e edhe me dhunën, gjithashtu është prezente edhe një ‘Heshtje ndaj bullizmit’ në mesin e tyre. Kjo për arsye se ata nuk ndihen të sigurtë në menagjimin nga të rriturit në ndërtesën e shkollës, por edhe përballen më

një frikë se *preket* reputacioni/statusi i tyre. Raste të tilla janë përmendur gjatë këtij punimi, të cilat forma bullizuese i përdorin edhe vetë mësimitdhënësit, drejtorja e shkollës, e mirëmbajtësit e shkollës.

Studimi poashtu gjeti se ka një dallim në gjini, sa i përket formave të shfaqura bullizuese mes tyre. Djemtë p.sh priren të shfaqin më shumë fizikun, kurse vajzat kanë tendencë të jenë më verbale ndaj situatave bullizuese.

Ndërkaq disa nga arsytet pse ndodh bullizmi, priren të jenë: aftësitë e individit, dukja, sfidat personale (vetë bullizuesi) etj.

Megjithatë, përpjekjet e mësimitdhënësve shihen të jenë të vazhdueshme në zvogëlimin e bullizmit, por jo ta zhdukin atë. Edhe përkundër rolit të shkollës në menaxhimin e bullizmit, njohuritë janë të pakta nga ana e mësimitdhënësve në lidhje me format, ligjet e politikat sa i përket bullizmit.

Dhe, për të bërë përpjekje më shumë në kuptimin e rëndësisë dhe parandalimit të bullizmit, studimi veçoi edhe disa faktorë të cilën dolën nga ky punim. Faktorë të tillë si: statusi socio-ekonomik, faktori teknologjik, struktura e familjes dhe aftësitë sociale janë vlerësuar për të përcaktuar pse ndodh ngacmimi. Dhe secili nga këta faktorë, ka luajtur një rol të rëndësishëm në aspektin e bullizmit. P.sh familja dhe shkolla janë në qendër të këtij diskutimi. Sepse raporti prind-nxënës dhe mësimitdhënës, vë në pah relacionin e përhapjes/reduktimit të bullizmit. I cili, ky studim tregon se llojet e bullizmit të sipërpërmendura, lidhen edhe me pasojat e tij tek këta fëmijë.

Andaj, përveç faktorëve të sipërpërmendur, stilet prindërore, statusi mes bashkëmoshatarëve, pranimi nga bashkëmoshatarët dhe klima e shkollës, përfaqësojnë faktorët e rrezikut të nivelit të mikrosistemit për incidencën e bullizmit në shkollë.

Andaj në përmbledhje, kuptojmë se mungesa e burimeve, trajnimeve e sidomos shërbimit pedagogjik, paraqet një sfidë si për mësimitdhënësit në aspekt individual, e poashtu është një sfidë edhe për vetë shkollën në menagjimin e bullizmit.